



**Republika e Kosoves**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Punes dhe Mireqenies Sociale**  
**Ministarstvo Rada i Socijalne Zastine – Ministry of Labor and Social Welfare**

---

*Prishtinë 20.04.2018*

**Për:** z. Ramush Haradinaj, Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Nga:** Lulzim Leci, Zëvendësministër në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale

**Subjekti:** Raport i punës

I nderuar Kryeministër,

Në bazë të përgjegjësive që dalin nga Rregullorja nr. 02/2011, për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ju lutem, gjeni të bashkangjitur Raportin e Punës, të angazhimit tim si zëvendësministër në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për periudhën 6 mujore.

Gjatë kësaj periudhe kohore, angazhimi im ka qenë i fokusuar në zhvillimin e politikave pensionale dhe politikave sociale:

- Realizimi i takimit njoftues rreth zbatimit të procedurave ligjore për realizimin e të drejtave të qytetarëve në fushën e pensioneve dhe mirëqenies sociale, komunikimin e drejtpërdrejtë me qytetarët, trajtimin e kërkesave sipas afateve ligjore, duke pasur parasysh se veprimet e zyrtarëve të këtyre dy departamenteve reflektojnë drejtpërdrejtë në mirëqenien e qytetarit.
- Mbatja e disa takimeve me përfaqësuesit e Lidhjes së Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës të Republikës së Kosovës dhe me përfaqësuesit e Sindikatës së Pavarur të Pensionistëve të Kosovës.
- Mbatja e disa takimeve me përfaqësuesit e Shoqatës së personave të verbër dhe me të Pamë të Dobësuar të Kosovës (SHVPDK)
- Realizim i takimit për njoftimin rreth Planit Vjetor të Punës së Qeverisë për vitin 2018. Tabela B (Prioritetet Sektoriale), në të cilën janë identifikuar Objektivat, vendosja e aktiviteteve që kanë të bëjnë me Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale/Departamenti i Pensioneve, afatet kohore, kosto financiare, institucionet e përfshira si dhe ndërlidhja me dokumente tjera strategjike.
- Informim rreth raportit të mjeteve të nevojshme, për implementimin e Ligjit nr. 05/L-067, për Statusin dhe të drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.
- Informim rreth Raportit narrativ bazuar në draft agjendën e takimit të dytë vjetor të MSA, kapitulli që ka të bëjë me Marrëveshjet Bilaterale për Sigurimet Sociale që dalin nga takimi i mbajtur në Prishtinë me datë 30 Nëntor 2017.
- Informim rreth përgatitjes së inputit të II-të për Raportin e KE-së për Kosovën për periudhën 1 tetor / 2017 deri 31 janar 2018, pjesa që ka të bëjë me Departamentin e Pensioneve.
- Informim rreth përgatitjes së Cash Planit (rrjedhjës së parasë) për vitin fiskal 2018, parashikimi i investimeve kapitale për periudhën Janar- dhjetor, bazuar në buxhetin e aprovuar për këtë vit.
- Takim me zyrtaret e departamentit të pensioneve lidhur me raportin për trendët e shtimit apo zvogëlimit të përfituesve nga skema e pensioneve të PPAK-së, krahasimi Janar-Dhjetor 2017 dhe raportit lidhur me trendet e zvogëlimit të përfituesve të skemave të pensioneve të PPAK-së, pas kalimit të një numri të tyre në skemat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

- Njoftim rreth Raportit për zbatimin e planit të Veprimit për implementimin e rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, në muajin shkurt 2018, për Departamentin e Pensioneve.
- Realizim i takimit me zyrtarët rreth planifikimit të shumës së mjeteve të nevojshme për periudhën Mars-Dhjetor 2018, për skemën e Pensionit Invalidor të punës, Familjar dhe kompensimit për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik.
- Njoftimi rreth Raportit për zbatimin e Planit të Brendshëm të Punës të Departamentit të Pensioneve për tremujorin e parë janar-mars 2018.
- Realizim i takimit rreth raportit përmbledhës mbi të arriturat në implementimin e strategjisë nacionale dhe planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2016-2020, pasi që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, sipas mandatit që ka në mbrojtjen e personave në nevojë sociale, me fokus të veçantë në mbrojtjen e fëmijëve, ka në programet e saj mbrojtjen direkte dhe ri-integrimin afatgjatë të tyre, politikat sociale parashohin, ofrimin e mbrojtjes sociale edhe për të rriturit viktime të çdo lloji të krimit.
- Njoftim rreth përmbushjes së obligimit që ka dalë nga „Ligji për Mbrojtje nga dhuna në Familje, nr. 03/L-182/, neni 27, MPMS në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Agjencinë për Barazi Gjinore e me pjesëmarrjen e grupit ndër-institucional ka hartuar Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje” dhe Planit të Veprimit 2016 – 2020. MPMS me qëllim të realizimit të përgjegjësisë që ka marrë në kuadër të këtij dokumenti strategjik po vazhdon me ofrimin e granteve dhe subvencioneve për shërbimet e strehimit, rehabilitimit dhe ri-integrimit për viktimat e dhunës në familje nga shtatë strehimoret që strehojnë viktime të dhunës në familje fëmijë dhe të rritur, vendor dhe të huaj.
- Duke pasur parasysh faktin se MPMS realizon marrëveshje dhe kontrata për subvencionimin e shërbimeve për mbrojtjen dhe strehimin e viktimave të dhunës në familje me shtatë strehimore në nivel nacional që nga viti 2006, jam angazhuar për së afërmi me gjendjen dhe trajtimin që bëhet në këto qendra strehimi.

- Njoftim rreth hartimit të Projektligjit për Inspektoratin e Punës, i cili javën e ardhshme finalizohet si draft final.